

Armët

Armët e zjarrit janë të ndaluara për të miturit (pushkët, armët e goditjes, etj). Mbatja e **thikave automatike** të “spyderco”¹ që qelet me një dorë, të thikave flutura², janë të ndaluara posa të jenë më të gjata se 12 cm të çelura me një teh që e tejkalon 5 cm. **Veglat luftarake për lëndime** (grusht amerikan, kopaçe, nunshaku, push dagger³ etj) janë rreptësisht të ndaluara.

Përdorimi me vetëdëshirë, për të lënduar, gjëra të shpeshta (shkopi i bas-bollit, kyter, shishe etj) janë gjithashtu të ndaluara.

¹Spyderco-sistemi i hapjes me një dorë, nuk është automatike, brisk i ndërrueshëm. Hapja është mekanike. Mjet që përdoret nga zjerrëfikësit etj.

²Thika flutur-sistemi i hapjes me një dorë, nuk është automatike, hapja bëhet në mënyrë mekanike. Doreza i ndërrohet kurse brisku është fiks.

³Push dagger- brisk simetrik apo asimetrik pa dorez.




Sipas rregullave shkollore voduaze, u ndalohej nxënësve të sjellin gjëra të rrezikshme në shkollë.

Rruga publike

Të miturit iu nënshtrohen rregullave të njejta sikurse i rrituri sa i përket sjelljeve në rrugë. Në rrugët publike, rregullat policore e ndalojnë kryesisht :

- pështyrjen apo urinimin,
- lëshuarjen në lojrat e rrezikshme apo hudhjen e letrave,
- mbeturinave apo gjërave të tjera.



Të rriturve dhe më të rinjëve ju rekomando het ta kenë një letërnjoftim me vete.

Të qenurit prindër : një rol kryesor

Fëmijët dhe adoleshentët, deri në pjekurinë e tyre (18 vjeç) janë nën përgjegjësinë e rindërve të tyre ose të përgjegjësit ligjor që e ka në ngarkesë. Ky udhërrëfyes nuk ofron kurrëfarë receta të gatshme. Ka për qëllim vetëm t’ju përkujton prindërve sa i përket ligjeve reth të miturve. Kjo broshurë e ndihmon caktimin e rregullave dhe e ushqen dialogun që është i domosdoshëm në vendosjen e rregullave edukative, duke i marrë parasysh obligimet dhe të drejtat e fëmijëve.

Të qenurit prindër nuk është çdo herë e lehtë dhe leximi i kësaj broshure mund të nxisë shumë pyetje. Nëse keni pyetje, kontaktoni profesionelët e rrethit tuaj ose thirrni në numrin e poshtë shënuar. Do të gjeni përgjigje ose do të drejtoheni kah profesionelët aktiv në fushën shkollore shoqërore dhe edukative, pranë policisë, pranë shërbimit të mbrojtjes së rinisë apo pranë shoqatave ose institucioneve të ndryshme:

Personat, institucionet apo shërbimet për referenca në regjion:

- Shërbimi për mbrojtjen e të rinjve +41 21 557 94 69
- Urgjenca 117 ose Policia komunale
- Sekretariati i shkollës
- www.chablaisfamille.ch : faqja (sajti) që ju dedikohet familjeve

Ndihma për adoleshentët:

- 147 Shërbimi për dëgjimin e të rinjëve
- www.ciao.ch : faqe interneti që ju dedikohet të rinjëve


Përmbledhje e shkurtër referencash juridike

CC art 272; LADB art. 50 et 51; RADB art. 40; CP art. 82 à 99, 111 à 115, 117 à 136, 177, 180 à 194, 221 à 226; LF sur l'alcool art. 41; Rgt d'application loi scolaire VD art. 176 et 180; LSUP, art. 19; RGP art. 38, 74 et 105; LTP art. 51; Loi VD sur les armes, art. 24; Larm art. 8 et 9; Loi VD sur le cinéma art. 36 et 42; Loi VD sur les activités économiques, art. 73 et 74; Convention VD-GE sur les âges d'admission au cinéma; Convention ONU relative aux droits de l'enfant; Jurisprudence du TF; <http://www.police.vd.ch/arme.htm>; <http://www.aigle.ch/police>

Përgjegjësit e botimit

Ville d'Aigle / Greffe municipal

www.aigle.ch



<< Prindërit dhe fëmijët ia kanë borxh njëri tjetrit ndihmën e ndërsjellë, vëmendjen dhe rrespektin(...). >> (Kodi civil i zvicëres)

Përmbledhje e vogël në përdorim për prindërit

Duke u rritur fëmiju gëzon liri më të mëdha. Përjeton përvoja të reja. Për ta ndihmuar të rritet dhe të mbrohet, por gjithashtu për t’i përkrahur prindërit në misionin edukativ, pushteti publik i ka dekretuar ligjet. Këto ligje përbëjnë rregullat kryesore, me ç’rast një përzgjedhje është grumbulluar në këtë udhërrëfyes. Në rast moskuptimi, vetëm versioni në gjuhën frengje është referencë.

Me përkrahjen e enteve shkollore të Aigle, Bex, Ollon, les Ormonts-Leysin apo Villeneuve

© Qyteti i Aigle 2005. E drejta e shumëzimit është e rezervuar.

Alkooli

Ligi e ndalon t'ju shitet apo t'ju ofrohet alkooli të rinjëve nën moshën **16 vjeçe**.

■ Birra dhe vera: shitja dhe ofrimi është e mundshme mbi moshën 16 vjeçe,

■ Alkoopops' koktele, aperitive dhe pije të destiluara: shitja dhe ofrimi është e mundur mbi moshën **18 vjeçe**.

Alkoopops-është përzierje e alkoolit të fortë dhe limonadës.



Sikur Rregullat shkollore, ashtu edhe Rregullat e policisë, saktësojnë që "fëmijët në moshën e shkollimit fillorë (obligativ) nuk guxojnë të konsumojnë pije alkoolike dhe të pinë duhan".

10 - 18
vjet



Droga

Ligi e ndalon prodhimin, ofrimin, shitjen dhe konsumimin e të gjitha llojeve të drogave të quajtura "të bu ta" (shanvre (kërp), bar, marihuana, kanabis etj), sintetike (ekstazi etj) apo të fortë (kokain etj).

Informata, këshilla dhe konsultime: Hapsira paragjyquese Aigle, Av. des Glariers 20, 1860 Aigle

+41 24 468 40 40

Informata, këshilla dhe konsultime: Azimut, Centre de compétences dépendances, Av. de la Gare 14, 1880 Bex
+41 24 463 03 77

Eshtë më se e njohur se drogat janë të rrezikshme për shëndetin. Joshja ndaj tyre mund të filloj herët. Duhet patur kujdes ndaj shenjave të para që do të tregojnë fillimin e konsumimit (demotivimi, mungesat në shkollë etj).

Entet publike

■ Një i ri nën moshën 16 vjeç, i pa shoqëruar nga përfaqësuesi i ligjshëm, nuk ka të drejtë të shkojë në **kafene, restorane, tea-rooms, pube** dhe **diskoteka**, i lejohet vetëm nëse është i pajisur me një leje me shkrim

- për moshën **10-të** deri **12-të** vjeç, kjo leje mund të pranohet deri në orën **18h00**, dhe,

- për moshën **12-të** deri **16-të** vjeç deri në orën **20h00**.

Autorizimi duhet të jetë i datuar dhe i nënshkuar, me mbiemër, adresë dhe numër telefoni të prindërve, emri dhe ditëlindja e fëmijut, gjithashtu edhe enti ku i lejohet ta frekuentojë.

■ **Sallonet** e lojrave dhe **ciberqendrat** janë të ndaluara për të rinjtë nën **16 vjeç**, pos nëse janë të shoqëruar nga përfaqësuesi i ligjshëm.

■ Të rinjtë më pak se **18 vjeçe**, nuk janë të autorizuar t'i frekuentojnë **klubet e natës**.



Ka shumë ente natës që konsiderohen si klube nate !

Duhani

Konsumimi i duhanit e dëmton rëndë shëndetin. Sa më i hershëm që është kontakti me duhanin, aq më i madhë është rreziku i varësisë. Ligi e ndalon shitjen e duhanit të miturve (nën 18 vj.)

Nga ana e tyre, rregullat e policisë saktësojnë që fëmijët e moshës shkollore duhet që, në të gjitha rrethanat të jenë të ndershëm dhe të kenë sjellje korrekte. Ata nuk pinë duhan.



Regullat shkollore voduaze e precizojnë që "nxënësve nuk u lejohet konsumimi i duhanit dhe i pijeve alkoolike".

10 - 18
vjet



Daljet gjatë natës

Të rinjtë nuk duhet të dalin natën pas orës **22h**, të pashoqëruar nga prindërit e tyre.

10 - 18
vjet

Shkelja e ligjit & dhuna

Një fëmijë, djalosh apo një i rritur mund të dënohet nga drejtësia nëse merr pjesë apo e then ligjin me sa vijon :

- dëmtim i pasurisë, vandalizëm, tage,
- udhëtimi pa biletë në transportet publike,
- vjedhje, fshehje të vjedhurash, vjedhje në bandë, vjedhje me dhunë,
- raket (marrje me dhunë e parave apo e gjësendeve tjera), kërcënime, sulm seksual,
- goditje me qëllim, lëndime nga moskujdesi, rrahje, pjesëmarrje në një përleshje,
- sulmim me fjalë (sharje) apo fizik, etj.

Kur janë të autorizuar nga prindërit e tyre që të kthehen vetëm në orët e vona (kinema, aktivitete të shoqatave etj) të rinjtë duhet të kthehen menjëherë në shtëpi. Mosha ligjore për kinema është e domosdoshme: prindërit nuk janë të autorizuar ta shkulin ligjin.



Nëse një i mitur është viktimë e sulmit "raket" apo të një sulmi seksual, është me rëndësi të bisedohet me prindërit apo me një të rritur dhe të mirret me seriozitet. Përndryshe, është me rëndësi të sinjalizohen sulmet e tilla në polici të komunës (117), në mënyrë që të mos lihet e padënueshme.